



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1414/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Ballkan Group Vizioni” shpk, me numër unik identifikues 811592684 me seli ne Fushë Kosovë rr.” Preshevës” nr.13, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sahit Bibaj avokat ne Prishtinë, kundër debitorit “The North Unicorn” L.L.C, me numër unik identifikues 810112186 me seli ne Prishtinë Zona Industriale, te cilin e përfaqësojnë Arianit Koci dhe Granit Vokshi avokat nga Prishtina, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës- Dhomat e Shkalles e Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.720/22 dt.17.08.2023, me datën 05.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e kreditorit Ballkan Group Vizioni shpk, me numër unik identifikues 811592684 me seli ne Fushë Kosovë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.720/22 i datës 17.08.2023, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës- Dhomat e Shkalles e Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.720/22 dt.17.08.2023, e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit “The North Unicorn” L.L.C, me numër unik identifikues 810112186 me seli ne Prishtinë Zona Industriale, ndërsa urdhrin përmbarimor P.nr.623/21 dt.08.11.2021 i lejuar nga përmbaruesi privat Eset Murati, e ka anuluar.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori përmes përfaqësuesit te autorizuar, për shkak të shkeljes esenciale te dispozitave te procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plote te gjendjes faktike dhe aplikimit te gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dyte këtë ankesë ta aprovoj si te bazuar, aktvendimin e atakuar ta ndryshoj ashtu që urdhrin përmbarimor ta lë në fuqi dhe procedura e përmbarimit te vazhdoj tutje ose aktvendimin e ankimuar ta prish dhe çështjen ta kthej ne shkallë te parë ne rivendosje, i kërkon edhe shpenzimet e procedurës.

Përgjigje ndaj ankesës së kreditorit kanë ushtruar përfaqësuesit e autorizuar të debitorit, me të cilën i propozojnë gjykatës së shkallës së dytë, ta refuzoj ankesën e kreditorit si të pabazuar, ndërsa aktvendimin e atakuar ta lë në fuqi.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Ballkan Group Vizioni” shpk, me numër unik identifikues 811592684 me seli ne Fushë Kosovë rr.” Preshevës” nr.13 “me datën 08.11.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit “The North Unicorn” L.L.C, me numër unik identifikues 810112186 me seli ne Prishtinë Zona Industriale, në bazë të kartelës analitike konto 600174 nga data 01.01.2021 deri me datën 30.10.2021 me te gjitha faturat e bashkangjitura propozimit për përmbartim.

Përmbartuesi Privat Eset Murati nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.623/21 dt.08.11.2021, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit nga faturat t’ia paguaj shumen prej 26,879.04 euro, me kamatë prej 8% ne vit si dhe shpenzimet e procedurës për propozim ne shumen prej 312 euro sipas tarifës se OAK.

Kundër urdhrin përmbartimor, debitori ka paraqitur prapësim me datë 19.11.2021, me pretendimin se faturat mbi bazën e te cilave është iniciuar procedura përmbartimore janë lëshuar nga një person tjetër juridik përkatësisht nga Vizioni Group shpk ndërsa ne propozimin për përmbartim si kreditor paraqitet Ballkan Group Vizioni. Subjekti juridik Ballkan Group Vizioni me numër te regjistrimit te biznesit 811592684 nuk ka legjitimitet real aktiv sipas nenit 29 par.3 te LPP-së, sepse kreditori ne fature është treguar qartë e ne propozim paraqitet një tjetër kërkues i borxhit.

Përgjigje në prapësim ka bërë kreditori me datën 22.11.2021, përmes se cilës pretendon se thirrjet e debitorit ne prapësim se faturat janë lëshuar nga një subjekt tjetër janë të sakta mirëpo debitori obligimin sipas faturave dhe për pagesën e tyre e ka pranuar ne bazë te kontratës mbi cesionin dt.23.08.2021. Pretendimet në prapësim janë te pabazuara, joligjor dhe nuk përmbajnë kushtet e parapara me nenin 71 te LPP, propozon që gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit ndërsa urdhrin përmbartimor ta vërtetoj.

Gjykata Komerciale e Kosovës, -Dhomat e Shkalles se Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes ne prapësim, ka nxjerr aktvendim KPPP.nr.720/22 dt.17.08.2023, me të cilin e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka anuluar urdhrin përmbartimor, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim te aktvendimit gjykata

thekson se faturat te cilat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim janë lëshuar nga subjekti Vizioni M.Z.I.I shpk ndërsa propozimi për përmbarim është ushtruar nga Ballkan Group Vizioni shpk si kreditor. Gjykata gjen se kreditori nuk është i autorizuar që në këtë procedurë te kërkoj përmbarim ndaj debitorit për arsye se në dokumentet mbi bazën e te cilave është lejuar urdhri, si kreditor është i shënuar një person tjetër nga këtu kreditori i përmbarimit Ballkan Group Vizioni shpk. Gjykata pati parasysh Kontratën mbi Cesionin dt.23.08.2021 mbi bazën e te cilës kreditori pretendon se borxhi qe buron nga faturat mbi bazën e te cilave është lejuar përmbarimi i është ceduar kreditorit Ballkan Group Shpk nga personi i tretë Vizion M.Z.I.I, mirëpo nga e njëjta kontratë nuk mund te dihet me saktësi nëse pikërisht kredia qe buron nga faturat mbi bazën e te cilave është lejuar urdhri përmbarimor i është ceduar këtu kreditorit Ballkan Group shpk nga ky subjekt, kjo pasi qe ne këtë kontrate kreditorit i është ceduar kërkesa ne vlerën prej 38,379.94 euro shumë kjo qe nuk përputhet me shumën e faturat mbi bazën e te cilave është lejuar urdhri dhe as me shumën e kërkuar si ne propozim për përmbarim. Sa i përket Kontratës se Cesionit gjykata i referohet nenit 31 par.1 te LPP pasi vlerëson se nuk i plotëson kushtet për te provuar se kredia i është kaluar këtij kreditorit nga subjekti tjetër i cili paraqitet si kreditori ne dokumentin e besueshëm, vlerëson se kontrata e cesionit nuk është vërtetuar pran organit kompetent ashtu siç përcaktohet me ligj, dhe rrjedhimisht kreditori ne mungesë te provës për vërtetim te kalimit te kredisë sipas dispozitës se cituar kërkesën nuk mund ta realizoj ne këtë procedurë. Bazuar nga këto arsye gjykata ka vendos si ne dispozitiv te këtij aktvendim.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 dhe neni 183 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton edhe sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Përkritazi kësaj çështje, edhe gjykata e shkallës së dytë bazuar ne shkresat e lëndës gjegjësisht në dokumentin mbi bazën e te cilit është lejuar përmbarimi përkatësisht faturat të cilat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim janë lëshuar nga subjekti Vizioni M.Z.I.I shpk ndërsa propozimi për përmbarim është ushtruar nga Ballkan Group Vizioni shpk si kreditor, e nga kjo del se kreditori nuk është i autorizuar qe ne këtë procedurë te kërkoj përmbarimin ndaj debitorit, ndërsa ne lidhje me Kontratën e Cesionit te datës 23.08.2021 vlerëson se kjo kontratë nuk mund te shërbej si dokument i besueshëm mbi bazën e se cilës mund te konkludohet saktë se pikërisht kredia qe buron nga faturat mbi te cilat është lejuar përmbarimi i është ceduar kreditorit Ballkan Group Vizioni shpk sepse Kontrata e Cedimit përmban vlerën e detyrimit ne shumën prej 38,379.94 euro dhe fakti tjetër është se e njëjta nuk është e vërtetuar nga organi kompetent ashtu siç parashohin dispozitat ligjore, përkatësisht neni 31 par.1 te LPP i cili mes tjerash parasheh që: *“Përmbarimi caktohet edhe sipas kërkesës së personit dhe në dobi të tij i cili në dokumentin përmbarues nuk është shënuar si kreditor, po qe se ai (me anë të dokumentit publik apo me*

dokument privat por të vërtetuar sipas ligjit) provon se kredia i është kaluar atij, apo se në ndonjë mënyrë tjetër ka kaluar tek ai". Po ashtu kjo gjykatë vlerëson se marrë parasysh datën e krijimit të Kontratës së Cesionit d 23.08.2021 ndërsa datën se kur është ushtruar propozimi për përmbarim 08.11.2021 rezulton se kreditori i parë ka pasur mundësi që propozimin për përmbarim ta ushtroj në emër të kreditorit të ri të cilit i ka bartur kërkesën të cilin veprim nuk e ka bërë, ashtu që bazuar në këto arsye edhe për gjykatën e shkallës së dytë një përfundim juridik i tillë i gjykatës së shkallës së parë është i drejt dhe i bazuar.

Gjykata e shkallës së dytë analizoi edhe pretendimet ankimore të kreditorit se gjykata e shkallës së parë ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale por vlerësoi se këto pretendime nuk qëndrojnë sepse janë të paargumentuara ashtu që të njëjtat i refuzoi ndërsa aktvendimin e atakuar të shkallës së parë e vërtetoi.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.1414/23 me datë 05.06.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha